

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXV, nr. 7984
E mërkurë, 5 shtunë 2025
Çmimi 0.50 €

ÇERDHET E ALBIN BABËS!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA TË DIELËN MBAN ZGJEDHJET PARLAMENTARE, PARTITË POLITIKE KANË VENDOSUR NË QENDËR TË FUSHATËS ZOTIMET PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE TË VENDIT

ZOTIMET PËR EKONOMINË, NË QENDËR TË FUSHATËS ZGJEDHORE



video: LVV



video: LDK



video: LDK



video: AAK

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, ka thënë se të gjitha projektet e paraqitura nga partitë politike do të ishin të dobishme për zhvillimin

ekonomik të vendit. Mirëpo, sipas tij, është vetëm çështje e partive politike se sa do t'i zbatojnë dhe në çfarë shtirije kohore. Por, për ekspertin e ekonomisë, ish-drejtorin e

Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Lekë Musa, programet e partive politike nuk pasqyrojnë si duhet nevojat e vendit për zhvillim ekonomik

SPECIALJA DËNON ME BURGIM SHALËN, JANUZIN DHE BAHTIJARIN

F.5



QEVERIA REALIZOI VETËM 38 % TË PLANIT KOMBËTAR PËR ZHVILLIM PËR PERIUdhËN JANAR - DHJETOR 2024

F.3

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 735
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SPORT



TERVELL BECK, MVP I JAVËS NË
SUPERLIGËN E BASKETBOLLIT

F.10

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANJIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Pesë persona qëllohen në një shkollë në Suedi

STOKHOLM, 4 SHKURT - Pesë persona janë qëllyar në një qendër edukimi për të rritur në Suedi, njoftoi policia më 4 shkurt.

Agjencia suedeze e lajmeve, TT, raportoi, pa specifikuar burimet, se sulmuesi ka bërë vetëvrasje. Policia nuk ka konfirmuar këto raportime, por pritet të mbajë një konferencë për medie.

Qendra e edukimit për të rritur gjendet në qytetin Orebro, rreth 200 kilometra në perëndim të Stokholmit.

Shkolla, e quajtur Risbergska, ka studentë mbi moshën 20-vjeçare, sipas uebfaqes së këtij

institucioni arsimor. Kjo shkollë ofron kurse të shkollës fillore dhe të mesme, kurse për gjuhën suedeze për emigrantët, trajnime profesionale dhe programe për personat me aftësi të kufizuara intelektuale. Ende nuk është e qartë nëse policia e ka përfshirë edhe keqbërësin në mesin e pesë personave të qëllyar.

Videot nga vendi i ngjarjes kanë shfaqur prani të madhe policore dhe të autoambulancave. Shkalla e lëndimeve që kanë pësuar viktimat ende nuk është e qartë. Studentët po strehohen në ndërtesat afër. Pjesë të tjera

të shkollës janë evakuuar pas dhunës. "Raportimet për dhunë në Orebro janë shumë serioze. Policia gjendet në vendin e ngjarjes dhe operacioni është duke u zhvilluar", tha për agjencinë e lajmeve TT ministri i Drejtësisë, Gunnar Stormmer.

Ndërkaq, në një konferencë për medie për një ngjarje tjetër, edhe një tjetër zyrtar qeveritar foli për dhunën në Orebro, që ka një popullsi prej afër 155 000 banorësh. "Qeveria po përcjell zhvillimet nga afër dhe është në komunikim me policinë", tha ministri për Punësim dhe Integrim, Mats Persson.



Patrullimi i përbashkët ajror ShBA - Filipine mbi Detin e Kinës Jugore nxit reagimin e Kinës

WASHINGTON, 4 SHKURT - Forcat Ajrore të Shteteve të Bashkuara dhe të Filipineve kanë mbajtur patrullime të përbashkëta mbi Detin e Kinës Jugore, duke zemëruar Kinën.

Edhe Kina kreu një "patrullim rutinor" mbi një cekëtinë të kontestuar.

Nën presidentin Ferdinand Marcos Jr., Filipinet dhe Shtetet e Bashkuara e kanë rritur angazhimin për sigurinë, pas rritjes së tensioneve mes Filipineve dhe Kinës në rrugën e dendur ujore.

Ushtrimi njëditor mes dy vendeve aleate u zhvillua në Detin e Filipineve Perëndimore, tha zëdhënësi e Forcave Ajrore të Filipineve, Maria Consuelo Castillo, duke e përdorur termin e Manilës për ujërat në Detin e Kinës Jugore, të cilat shtrihen brenda zonës së saj



ekonomike. "Synimi i ushtrimit ishte përmirësimi i koordinimit operacional, rritja e ndërjegjësimit mbi hapësirën ajrore dhe forcimi i aftësive për përdorimin fleksibil të forcës luftarake midis dy forcave ajrore", tha

Castillo në një deklaratë. Castillo tha se në ushtrim morën pjesë tre avionë luftarakë filipinas, FA-50, dhe dy bombardues amerikanë B1-B, duke përfshirë një fluturim mbi cekëtinën Scarborough, ku forcat ajrore

kineze kryen atë që e quajten patrullë rutinore.

Ushtria e Kinës i akuzoi Filipinet se iu bashkua patrullimeve që, sipas saj, ishin organizuar nga vende të huaja për ta "minuar paqen dhe stabilitetin në Detin e Kinës Jugore".

Njësitë e forcave ajrore kineze do të "jenë në gatishmëri të lartë, do ta mbrojnë me vendosmëri sovranitetin territorial dhe të drejtat detare të Kinës dhe do ta kontrollojnë çdo aktivitet ushtarak që destabilizon Detin e Kinës Jugore", shtoi ajo.

Kina pretendon se pothuajse e gjithë kjo rrugë ujore strategjike është e saj pavarësisht prej pretendimeve nga Indonezia, Malajzia, Filipinet dhe Vietnamit. Kjo rrugë ujore është rrugëkalim për tregti vjetore në vlerë 3 trilionë dollarë.

Në një konferencë për shtyp të martën, marina filipinase tha

se po i "vëzhgon nga afër" tri anije të marinës kineze brenda zonave detare të Manilës, përfshirë një fregatë të pajisur me raketa. "Prania e Marinës së Ushtrisë Çlirimtare Popullore pasqyron shpërfilljen e plotë të ligjit ndërkombëtar nga Republika Popullore e Kinës ndaj dhe minon paqen dhe stabilitetin në rajon", tha zëdhënësi i marinës, John Percie Alcos.

Të hënën agjencia shtetërore e lajmeve "Xinhua" tha se kalimi i flotës kineze ishte në përputhje me ligjin ndërkombëtar, duke cituar një zëdhënësi të Komandës së Zonës Jugore të PLA-së.

Një tribunal ndërkombëtar i arbitrazhit vendosi në vitin 2016 se pretendimet e Kinës, të bazuara në hartat e saj historike, nuk kanë asnjë bazë ligjore ndërkombëtare, por Pekini nuk e njeh këtë vendim.

Trumpi shtyn vënien e tarifave ndaj Meksikës dhe Kanadasë

WASHINGTON, 4 SHKURT - Presidenti amerikan Donald Trump tha se do ta pezullojë vendosjen e tarifave të planifikuara ndaj Meksikës dhe Kanadasë për një muaj, pas negociatave në çastet e fundit me dy shtetet fqinje.

Ndërkohë, tarifatat ndaj mallrave kineze hynë në fuqi të hënën pas mesnatës.

Si kryeministri kanadez Justin Trudeau ashtu edhe presidentja meksikane Claudia Sheinbaum thanë se u pajtuan për t'i rritur përpjekjet për zbatimin e kontrollit kufitar, duke iu përgjigjur kërkesës së Trumpit për t'i luftuar imigracionin

dhe kontrabandën e drogës. Kjo bëri që Trumpi ta shtyjë për 30 ditë vendosjen e tarifave që pritej të hynin në fuqi të martën.

Kanadaja u pajtua të vendosë teknologji të re dhe personel përgjatë kufirit të saj me Shtetet e Bashkuara, si dhe t'i fillojë përpjekjet për bashkëpunim për ta luftuar krimin e organizuar, kontrabandën e fentanilit dhe shpëlarjen e parave.

Meksika u pajtua ta forcojë kufirin e saj verior me 10 000 anëtarë të Gardës Kombëtare për ta frenuar fluksin e imigracionit të paligjshëm dhe të drogës.



Shtetet e Bashkuara, gjithashtu, u angazhuan për parandalimin e trafikimit të armëve të fuqishme drejt Meksikës, tha Sheinbaum. "Si president, është përgjegjësia ime ta garantoj sigurinë e të gjithë amerikanëve, dhe po bëj pikërisht këtë. Jam shumë i kënaqur me këtë rezultat fillestar", tha Trumpi në rrjetet sociale.

Marrëveshjet, tani për tani, shmangin fillimin e një lufte tregtare që ekonomistët parashikuan se do t'i dëmtonte ekonomitë e të gjitha vendeve të përfshira dhe do të sillte çmime më të larta për konsumatorët.

Qeveria realizoi vetëm 38 % të Planit Kombëtar për Zhvillim për periudhën janar -dhjetor 2024

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 4 SHKURT - Lëvizja FOL ka publikuar të dhënat nga analiza e programit të Qeverisë së Kosovës 2021-2025 si dhe të dhënat nga monitorimi i Planit Kombëtar për Zhvillim për periudhën janar - dhjetor 2024. Burbuqe Kastrati, menaxhere e projektit në Lëvizjen FOL, tha se FOL ka bërë monitorimin e aktiviteteve të parapara në Planin Kombëtar për Zhvillim dhe për katër vjet të qeverisë së fundit. "Qeveria e Kosovës nga 544 aktivitete të parapara të realizohen brenda periudhës janar - dhjetor 2024 ka arritur të realizojë vetëm 207 apo 38 % nga to, ndërkaq 163 apo 30 % kanë mbetur të përealizuara. Ndërsa për 174 aktivitete apo (32 %) nga tri ministri (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë), FOL nuk ka pranuar përgjigje se sa janë realizuar aktivitetet e tyre për vitin 2024", ka thënë ajo.

Kastrati ka listuar ministrinë të cilat s'kanë planifikuar asnjë aktivitet për periudhën janar - dhjetor 2024 të cilat janë: Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe Ministria e Zhvillimit Rajonal. "Pra ka aktivitete në Planin Kombëtar Zhvillimor, realizimi i të cilave është paraparë të bëhet përgjatë disa vjetëve. Por, FOL ka bërë monitorimin e aktiviteteve të parapara që fillojnë në janar dhe përfundojnë në dhjetor 2024", është shprehur Kastrati.

Burbuqe Kastrati, gjithashtu, ka paraqitur të dhënat për secilën ministri sa i përket realizimit të aktiviteteve të parapara të përfundojnë brenda periudhës janar - dhjetor të vitit 2024.

Zyra e kryeministrit kishte paraparë 62 aktivitete të realizohen gjatë periudhës janar - dhjetor 2024 në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim, nga to janë realizuar 35 dhe 27 kanë mbetur pa u realizuar. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim ka paraparë të përfundojnë 29 aktivitete brenda periudhës janar - dhjetor 2024. Prej tyre kanë realizuar 19, ndërkaq 10



janë të përealizuara. Ministria e Drejtësisë, në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim, ka paraparë t'i përfundojë 79 aktivitete brenda periudhës janar-dhjetor 2024. Vetëm 44 janë përfunduar brenda afatit të paraparë, ndërkaq 35 janë të papërfunduara. Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim, ka paraparë t'i përfundojë 20 aktivitete brenda periudhës janar - dhjetor 2024, prej të cilave ka realizuar 9 dhe 11 janë të përealizuara. Ministria e Ekonomisë, në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim, ka paraparë të përfundojë 30 aktivitete brenda periudhës janar - dhjetor 2024, 14 janë realizuar brenda afatit të paraparë, ndërkaq 16 janë të përealizuara. Ministria e Punëve të Brendshme, në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim, ka paraparë t'i përfundojë 71 aktivitete brenda periudhës janar - dhjetor 2024. Vetëm 41 janë përfunduar brenda afatit të paraparë, ndërkaq 30 janë të përealizuara. Ministria e Mbrojtjes ka paraparë të realizojë vetëm 6 aktivitete gjatë periudhës janar - dhjetor 2024 në kuadër të Planit Kombëtar Zhvillimor, 2 janë realizuar dhe 4 të përealizuara. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka paraparë të realizojë vetëm 4 aktivitete gjatë periudhës janar - dhjetor 2024

në kuadër të Planit Kombëtar Zhvillimor, 1 ka realizuar dhe 3 kanë mbetur përealizuara. Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në kuadër të Planit Kombëtar për Zhvillim ka paraparë të realizojë 45 aktivitete, ka realizuar 30 dhe 15 kanë mbetur pa u realizuar. Ministria e Shëndetësisë ka paraparë të realizojë 21 aktivitete gjatë periudhës janar - dhjetor 2024 në kuadër të Planit Kombëtar Zhvillimor, 10 janë realizuar dhe 11 të përealizuara. Ministria për Komunitete dhe Kthim ka paraparë të realizojë vetëm 3 aktivitete gjatë periudhës janar - dhjetor 2024 në kuadër të Planit Kombëtar Zhvillimor, 2 janë realizuar dhe 1 e papërealizuar. Ndërkaq tri ministri nuk janë përgjigjur në pyetësorin e Lëvizjes FOL dhe nuk dihet nëse i kanë realizuar aktivitetet e parapara. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve në kuadër të Planit Kombëtar Zhvillimor ka paraparë të përfundojë 57 aktivitete brenda periudhës janar-dhjetor 2024. Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës në kuadër të Planit Kombëtar Zhvillimor ka paraparë të përfundojë 66 aktivitete. Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka planifikuar të realizojë 51 aktivitete për vitin 2024, nga e cila s'kemi pranuar përgjigje se sa nga to janë realizuar.

Ajo çka vlen të theksohet është se dy nga këto ministri, ajo e Financave dhe e Mjedisit, nuk janë përgjigjur as në gjashtëmujorin e parë kur FOL ka dërguar kërkesë. FOL kishte paraqitur ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi dhe pas ndërmarrjes së hapave nga AIP kemi pranuar përgjigje. Mirëpo kanë hezituar të përgjigjen dhe tani, FOL ka dërguar përsëri ankesë në Agjencinë për Informim dhe Privatësi për mosqasje në këto të dhëna sa i përket realizimit të Planit Kombëtar për Zhvillim për vitin 2024. Sipas Kastratit, Lëvizja FOL ka bërë krahasimin ndër vite të realizimit të aktiviteteve në kuadër të Planit Kombëtar Zhvillimor të parapara të përfundojnë brenda vitit për vitet 2021, 2022, 2023 dhe 2024. Në vitin 2021 niveli i zbatimit të Planit të Punës së Qeverisë ka rezultuar të jetë 56 %, ndërsa në vitin 2022 Qeveria e Kosovës kishte realizuar 62 %, në vitin 2023 kishte realizuar 36 % dhe në vitin 2024 Plani Kombëtar për Zhvillim është realizuar vetëm 38 % për periudhën janar - dhjetor. Duke u bazuar në këto të dhëna del se puna e qeverisë ka pësuar rënie sa i përket realizimit të planit të punës, i quajtur tani Plani Kombëtar për Zhvillim dhe realizimi më i madh i tij po del në vitin 2022, 62 %. E Mexhide Demolli - Nimani, drejtoreshë e Lëvizjes FOL, tha se pavarësisht prej monitorimit

të realizimit të aktiviteteve në kuadër të Planit Kombëtar Zhvillimor për vitin 2024, kemi analizuar edhe Programin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2021-2025. "Duke qenë se është qeveria e parë me mandat të plotë që nga shpallja e pavarësisë, ne kemi bërë edhe një analizë të Programit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitet 2021-2025, i miratuar më 7 maj 2021. Ky program paraqiti një vizion ambicioz për zhvillimin ekonomik, social dhe institucional të vendit. Megjithatë, zbatimi i këtij programi është përballur me sfida serioze që kanë penguar arritjen e objektivave kryesore. Ndër sfidat kryesore janë vonesat në miratimin e politikave, defektet legjislative dhe mungesa e koordinimit ndërinstitucional", tha ajo.

Programi i qeverisë ka paraparë dy prioritetet kryesore të asaj kohe që kanë qenë menaxhimi i pandemisë Covid-19 dhe ringjallja ekonomike. Kurse sa i përket aspektit sektorial, Programi i Qeverisë është i ndarë në 18 prioritetet, ku përfshihen: Shëndeti publik dhe mbrojtja sociale, Sundimi i ligjit, Rendi dhe siguria publike, Qeverisja, Të drejtat e njeriut dhe barazia gjinore, Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të komuniteteve etj. Sipas saj, në mënyrë që të zbatohet Programi, qeveria është dashur të ndërmarrë veprime për miratimin e ligjeve si hapa paraprakë në zbatim të programit. "Megjithatë, një nga problemet më të dukshme ka qenë vonesa në miratimin dhe zbatimin e ligjeve. Një numër i madh projektligjesh të miratuara nga Kuvendi i Kosovës janë kontestuar për shkelje procedurale dhe janë dërguar në Gjykatën Kushtetuese", tha ajo.

Demolli-Nimani tha se kjo analizë duhet të shërbejë për qeverinë e ardhshme që Programi qeverisës të jetë i bazuar në një qasje të mirorganizuar, realiste dhe larg premtimeve të paarsyeshme apo të vështira për t'u realizuar në praktikë. Gjithashtu, është thelbësore që qeveria të jetë transparente dhe e përgjegjshme para qytetarëve, duke u bazuar në ligjshmëri dhe kushtetutshmëri.

Afati për regjistrimin e personave me nevoja të veçanta për votim mbyllet më 5 shkurt

PRISHTINË, 4 SHKURT - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka njoftuar se afati për regjistrim për votim të personave me nevoja të veçanta është deri më 5 shkurt 2025 në ora 16:00. Sipas njoftimit nga KQZ-ja, regjistrimi duhet të bëhet përmes platformës

elektronike në uebfaqe www.kqz-ks.org, duke klikuar butonin "Regjistrimi i Personave me Nevoja të Veçanta" ose përmes zyrate të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve në komunën tuaj. "Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ju mundëson pjesëmarrjen në zgjedhje

personave që, për arsye të ndryshme nuk mund të shkojnë në vendvotim. Këta persona mund të regjistrohen për të votuar në shtëpi ose në vendet e tjera ku gjenden, siç janë spitalet, shtëpitë e moshuarve, apo edhe për ata që janë në arrest shtëpiak", thuhet në njoftim.





Specialja dënon me burgim Shalën, Januzin dhe Bahtijarin

Shala, Januzi dhe Bahtijari e pranuan fajësinë për frikësim të dëshmitarëve dhe për pengim të drejtësisë, pasi arritën marrëveshje me Prokurorinë e Specializuar në fund të dhjetorit 2024

HAGË, 4 SHKURT - Dhomat e Specializuara të Kosovës me seli në Hagë kanë shpallur fajtorë dhe kanë dënuar Haxhi Shalën, Sabit Januzin dhe Ismet Bahtijarin lidhur me akuzat që kanë të bëjnë me pengim të drejtësisë. Kështu trupi gjyqësor pranoi marrëveshjen e fajësisë që të akuzuarit arritën më herët me Prokurorinë e Specializuar. Shala u dënua me tre vjet burgim, ndërkaq Bahtijari dhe Januzi me dy vjet burgim. Koha e qëndruar në paraburgim, sipas trupit gjyqësor, do t'u llogaritet në dënim. "Sa i takon kohës së llogaritur në paraburgim, trupi gjyqësor vëren se zoti Januzi dhe Bahtijari janë arrestuar më 5 tetor 2023 dhe të dy janë ndaluar në ambientet e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës më 6 tetor 2023. Trupi gjyqësor e zbrit kohën e paraburgimit që prej 5 tetorit 2023. Sa i takon zotit Shala, trupi gjyqësor vëren se ai është arrestuar më 11 dhjetor 2023 dhe ka qenë i ndaluar në ambientet e paraburgimit të Dhomave të Specializuara që nga 12 dhjetori i vitit 2023. Për

rrjedhojë e zbrit kohën e paraburgimit që prej 11 dhjetorit 2023", tha gjykatësja teksa lexoi vendimin e trupit gjyqësor. Gjatë seancës tre të akuzuarit u deklaruan se janë pajtuar të paguajnë në total 500 euro për zhdëmtimin e viktimës në këtë rast, të identifikuar vetëm si "viktima 01". Sipas marrëveshjes, 400 euro do t'i paguajë Shala, 100 Januzi, ndërkaq Bahtijari nuk do të paguajë për zhdëmtim. Kjo shumë duhet t'i paguhet viktimës deri më 19 shkurt. Pas seancës në Hagë, kryeprokurorja e specializuar, Kimberly West, mirëpriti vendimin e Dhomave, duke theksuar se kjo është hera e parë që të akuzuarit në Hagë pranojnë vullnetarisht fajin. "Marrëveshjet e pranimit të fajësisë janë precedent historik për faktin se ato përfaqësojnë rastin e parë kur të akuzuarit në Dhomat e Specializuara pranojnë vullnetarisht fajin e tyre", tha West sipas një njoftimi për medie të lëshuar nga Prokuroria e Specializuar. "Ky

zhvillim është me rëndësi kritike për mbrojtjen e integritetit të procedurave në Dhomat e Specializuara, si dhe një hap përpara për administrimin e drejtësisë në Kosovë", shtoi West.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë

Shala, Januzi dhe Bahtijari e kishin pranuar fajësinë për frikësim të dëshmitarëve dhe për pengim të drejtësisë, pasi arritën marrëveshje me Prokurorinë e Specializuar për pranimit të fajësisë në fund të dhjetorit 2024. Në marrëveshjen e tyre me Prokurorinë lidhur me pranimit e fajësisë, Shala u pajtua me një dënim deri në tri vjet burgim, Januzi me një dënim nga 24 deri në 30 muaj, ndërkaq Bahtijari u pajtua se, në rast se gjykata e dënon me dy vjet burgim ose më pak, ai nuk do të ketë të drejtë apeli ndaj vendimit. Që të tre akuzoheshin se kishin bashkëpunuar për ta nxitur një dëshmitar të mos dëshmonte para Dhomave të Specializuara dhe Prokurorisë së Specializuar, që njihen edhe si Gjykata Speciale. Nuk është bërë me dije se për cilin dëshmitar bëhej fjalë, as në cilin rast parashihej të dëshmonte ai.

Çfarë thotë aktakuza për Shalën, Januzin e Bahtijarin?

Aktakuza e konfirmuar për tre të akuzuarit më 10 korrik të vitit 2023 thotë se në periudhën midis 5 dhe 12 prillit 2023 Haxhi Shala, bashkë me Sabit Januzin dhe Ismet Bahtijarin, kontaktuan një dëshmitar. Më saktësisht, sipas aktakuzës, Ismet Bahtijari i bëri një vizitë dëshmitarit në shtëpinë e tij më 5 prill, ndërsa Sabit Januzi bëri një vizitë më 12 prill. Më tutje në aktakuzë thuhet se dëshmitarit iu kërkua tërheqja e dëshmisë dhe iu ofruan përfitime në këmbim. Vepra në grup, sipas Prokurorisë, u krye nën direktivën e Haxhi Shalës. Ndërkohë, Dhomat e Specializuara të Kosovës deri më tani kanë shpallur dy aktgjykime për pengim në administrim të drejtësisë. Dy ish-figura të Organizatës së Veteranëve të UÇK-së, Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj, janë dënuar për pengimin e drejtësisë deri tani. Ndërkaq, më 6 dhjetor 2024 Gjykata Speciale në Hagë konfirmoi një aktakuzë të re kundër ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, si dhe kundër katër personave të tjerë për vepra penale që lidhen me

"pretendime për përpjekje të paligjshme për të ndikuar në dëshmitë e dëshmitarëve në gjykimin e krimeve të luftës Thaçi dhe të tjerët". Dhomat e Specializuara të Kosovës thanë se aktakuza u konfirmua kundër Hashim Thaçit, ish-ministrit të Drejtësisë, Hajredin Kuçi, ish-shefit të Agjencisë së Kosovës për Inteligjencë, Bashkim Smakaj, ish-kryetarit të Malishevës, Isni Kilaj, dhe Fadil Fazliut. Specialja ka shqiptuar edhe dy aktgjykime për krime lufte. Gjykata Speciale u themelua në vitin 2015 nga Kuvendi i Kosovës dhe është pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, por vepron me personel ndërkombëtar dhe ka selinë në Hagë. Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar hetojnë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të kryera kundër pakicave etnike dhe rivalëve politikë që nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000. Aktualisht në Dhomat e Specializuara janë duke u zhvilluar disa raste gjyqësore, përfshirë edhe rastin ndaj ish-krerëve të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Jakup Krasniqi dhe Rexhep Selimi, që akuzohen për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

KOSOVA TË DIELËN MBAN ZGJEDHJET PARLAMENTARE, PARTITË POLITIKE KANË VENDOSUR NË QENDËR TË FUSHATËS ZOTIMET PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE TË VENDIT

Zotimet për ekonominë, në qendër të fushatës zgjedhore

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, ka thënë se të gjitha projektet e paraqitura nga partitë politike do të ishin të dobishme për zhvillimin ekonomik të vendit. Mirëpo, sipas tij, është vetëm çështje e partive politike se sa do t'i zbatojnë dhe në çfarë shtirje kohore. Por, për ekspertin e ekonomisë, ish-drejtorin e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Lekë Musa, programet e partive politike nuk pasqyrojnë si duhet nevojat e vendit për zhvillim ekonomik

PRISHTINË, 4 SHKURT - Kosova mban të dielën zgjedhjet parlamentare që shihen gjerësisht si një sprovë për kryeministrin Albin Kurti, partia e të cilit fitoi me rezultat të thellë në vitin 2021.

Partitë politike kanë vendosur në qendër të fushatës së tyre zotimet për rimëkëmbjen ekonomike të vendit që përballet me papunësi, inflacion dhe nevojën për më shumë investime të huaja. "Gjatë mandatit të ardhshëm paga minimale do të rritet mbi 500 euro, paga minimale nuk do të tatohet e kjo nënkupton që edhe për biznesin e vogël individual 6 mijë eurot e para të tatimit vjetor do të jenë të liruar nga tatimi", tha gjatë një tubimi kryeministri Albin Kurti. "Në muajt e parë të qeverisjes sime pagat do t'i rris për 50 për qind... Përveç pagat për 70 për qind, do t'i rris pensionet bazike, do t'i rris edhe pensionet kontributdhënëse të cilat do të përshkallëzohen sipas viteve të punës", tha gjatë një tubimi kandidati për kryeministër i Partisë Demokratike, Bedri Hamza. Kandidati për kryeministër i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka thënë se në programin e LDK-së kanë paraparë pesë miliardë euro investime. "Në programin tonë politik kemi pesë miliardë euro investime, pesë miliardë euro buxhet, pesë për qind rritje ekonomike... Që në javën e parë, asnjë javë tjetër më shumë, të gjithë shërbyesve publikë në Kosovë, të gjithë mësuesve, mjekëve, zjarrfikësve, ushtarëve, të gjithë punëtorëve të shtetit do t'u rrisim pagat me koeficient 150", tha Abdixhiku.

E kandidati për kryeministër nga koalicioni Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë: "Unë kam thënë do t'i dyfishojmë pagat. Kjo do të ndodhë në sektorin publik, por do ta përmirësojmë edhe pozitën e punëtorëve në sektorin privat, për shkak se, ju tregova, ne do të bëhemi partnerë të bizneseve, do t'u japim atyre mundësi të investojnë e të



bashkëinvestojnë me shtetin, me popullin".

Zotimet janë të shumta, por sa janë të realizueshme këto premtime? Ekspertët me të cilët bisedoi "Zëri i Amerikës" shprehin këndvështrime të ndryshme rreth mundësive për realizimin e zotimeve.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, thotë se të gjitha projektet e paraqitura nga partitë politike do të ishin të dobishme për zhvillimin ekonomik të vendit. "Mirëpo është vetëm çështje e partive politike se sa do t'i zbatojnë dhe në çfarë shtirje kohore do t'i implementojnë. Kjo është ajo që pret biznesi. E mira është që asnjë masë nga të gjitha partitë, duke përfshirë edhe atë në pushtet, deri më sot nuk ka paralajmëruar ngritjen e ndonjë takse. Kjo është ajo ana pozitive", thotë ai.

Për ekspertin e ekonomisë, ish-drejtorin e Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, Lekë Musa, programet e partive politike nuk pasqyrojnë si duhet nevojat e vendit për zhvillim ekonomik. "Ajo që kemi mundur të dëgjojmë janë

premtime koti në shumicën e rasteve, të cilat nuk kanë në prapavijë një analizë të tillë se a u duhen këto masa qytetarëve të Kosovës, a e shpien vendin përpara dhe çfarë do të jetë rezultati i këtyre masave të cilat ndërmerren", tha ai.

Rrethanat aktuale, thotë zoti Rafuna, kërkojnë udhëheqës të hapur për dialog publiko-privat, ashtu që të gjenden mundësitë për trajtimin e problemeve thelbësore. "Kemi ndryshime shumë të mëdha jo vetëm në Kosovë e Ballkan, por edhe në Bashkimin Evropian dhe në Shtetëpinë e Bardhë, por edhe në tregje tani me vendosjen e tarifës së tatimit doganor nga ana e administratës Trump. Kjo do të ketë një efekt global në tregti. Shtu këtu që Kosova është edhe nën masa ndëshkuese. Ne nuk po mund të përfitojmë projekte kapitale nga Komisioni Evropian. Deri më tani vlera e tyre ka shkuar gati 300 milionë", thotë Rafuna.

Ai thotë se vendi vuan për investime të huaja cilësore edhe për shkak të krizave të vazhdueshme si ato në veri të vendit. "Investitorë potencialë të cilët kanë

ardhur në Odën Ekonomike për t'i parë mundësitë për investime në Kosovë, pyetja e parë e tyre ka qenë se kur do të bëhet luftë në Kosovë? Për shkak të sulmit ndaj ushtarëve të KFOR-it, bllokimi i rrugëve, më pas thirrjet që nuk kanë qenë mesazh i mirë nga ana e udhëheqësve tanë se po sulmohemi e do të sulmohemi nga Serbia", thotë Rafuna.

Për Musën rritja e premtuar e pagave është proces që kërkon kohë dhe ndryshime të mëdha buxhetore. "Në momentin kur ta kemi qeverinë e re, ndoshta me ndryshime buxhetore në mes të vitit, mund të realizohen këto premtime. Mirëpo duhet thënë se për çfarëdo lloji ndryshimi, siç thashë edhe për reforma të tjera, duhet të ketë një analizë se përse duhet të ketë rritje të pagave në sektorin publik, cili do të jetë efekti i tij pastaj në sektorin privat? A ndikon në konkurrueshmërinë e Kosovës në tërheqje të investimeve të huaja? Cili do të jetë efekti në inflacion? Sa është rritja ekonomike? Sa jemi konkurrues pastaj me rajonin? Të gjitha këto duhet

të jenë pjesë e këtyre premtimeve", tha Musa.

Ndërkaq Rafuna tha se sektori privat ka lëvizur me rritjen e pagave. "Sektori privat ka lëvizur me rritjen e pagave, diku më shumë e diku më pak, varësisht si i kanë pasur kërkesat dhe mundësitë, mirëpo duhet edhe sektori publik të lëvizë. A është e realizueshme? Patjetër që është e realizueshme sepse ke ngritje ekonomike dhe mundësi buxhetore", thotë Rafuna.

Në vlerësimin e fundit të Bankës Botërore për Kosovën, të përditësuar në tetor të vitit të kaluar, thuhet se vendi ka shënuar përparim të qëndrueshëm ekonomik që nga shpallja e pavarësisë, me një rritje prej 50-përqindësh të të ardhurave për kokë banori dhe një ulje prej 35-përqindësh të shkallës së varfërisë. Megjithatë, për ta vazhduar rritjen ekonomike, Kosovës i duhen më shumë vende cilësore të punës, nëpërmjet trajtimit të pengesave të infrastrukturës, investimeve në kapitalin njerëzor dhe krijimin e një mjedisi më të favorshëm për zhvillimin e sektorit privat.

ÇERDHE E ALBIN BABËS!



Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA

1 me 160: LV-ja në zgjedhjet e fundit, midis të tjerash, premtoi ndërtimin e 160 çerdheve për fëmijë dhe për jetësimin e këtij premtimi duhej personi i duhur me integritet njerëzor, kombëtar, profesional dhe moral. Midis "xhevahireve" të kësaj partie multietnike kishte shumë kandidatë por, Albin Baba dhe Baba Dejana u përcaktuan për analfabetin nr. 1 në Kosovë dhe më gjerë, Arbërie Nagavci, me emrin artistik Pambuke që, midis nesh, thuhet se i di plot 29 shkronja të alfabetit shqiptar. Krahasuar me alfabetin e Naum Veqilharxhit, zonja Pambuke Nagavci është shumë më e përparuar, ka tri shkronja më shumë. Krahasuar me alfabetin e sotëm të gjuhës shqipe, zonjës Pambuke i mungojnë shtatë shkronja të cilat, nëse kemi parasysh shkallën e analfabetizmit real, janë të panevojshme. Duke filluar nga Akademia mendermethënë e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës e deri te niveli më i ulët institucional, ka shumë probleme me drejtpërdorimin e së paku 10 shkronjave, prandaj zonja Pambuke Nagavci ka bërë mirë që është ndalur te numri i 29 shkronjave e jo 36. ASHAK-u është epiqendra e ringjalljes së analfabetizmit funksional sikur edhe sarkofagu ku janë varrosur vetëdija dhe ndërgjegjja kombëtare por, në të njëjtën kohë dhe vend ku me pasion dhe danatizëm

mirëmbahet nostalgjia jugosllave përmes atyre që kanë qenë në shërbimin zbulues dhe kundërzbulues jugosllav dhe serb e që, me ndihmën e të gjitha pushteteve, më së shumti në regjimin e Albin Kurtit, janë kacavjerrë në majat e këtij institucioni, që ko që nuk është ajka e trurit sikur në vendet e tjera, por është shndërruar në hirrë që moti i ka kaluar afati i përdorimit, por që ky afat i zgjatet me falsifikimin e etiketave mbi kohën e përdorimit. Zonja Pambuke Nagavci nuk e plotëson asnjërin nga kriteret e lartpërmendura si integriteti njerëzor, kombëtar, moral dhe profesional, prandaj është emëruar ministre e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Duke u marrë tërë kohën me përhapjen e analfabetizmit dhe luftimin e përparimtares, nuk ka mundur t'i ndërtojë 160 çerdhe, madje as 10. Po edhe nuk ka nevojë sa të jetë gjallë Albin Baba që ka zgjidhje për të gjithë analfabetët dhe trushpërlarët, sidomos. Albin Baba është njeri i thjeshtë, popullor, folklorik dhe diabolik. Hanë pasul me hoxhën, fletë për freska me priftin dhe luan qoç... me popullin. Papa Françesku ua lanë këmbët të burgosurve dhe të mjerëve kurse Albin Babës dhe Agim Zezës të mjerët ua puthin duart dhe faqen e fytyrës me shumë fytyra. Dhe nëpër oborre, ahure, bodrume dhe tarraca ua ndërtojnë shtatoret me para të Kolumbisë dhe Ekuadorit. Thonë se nga mielli varet jeta por duket se nga mielli sigurohet edhe lavdia! Albin Baba është kallauz për të gjitha dyert e kësaj bote dhe doli të jetë shpëtim edhe për Pambuke Nagavcin. Nuk mori përsipër ndërtimin e 160 çerdheve sepse ato para mund të përdoren më mirë dhe për qëllime të larta humane si p. sh., zgjidhja e çështjes së mbijetesës për Martin Berishën

dhe martinët e tjerë, për përmirësimin e dukjes fizike të ministrave dhe ministreve përmes operacioneve plastike, importimin e sasive të mjaftueshme të botoksit dhe nevoja tjera aq të domosdoshme për popullin e Albin Babës. Albin Baba ka marrë përsipër të rrisë dhe edukojë të gjithë fëmijët prandaj nuk duhen fare çerdhe të reja. Albini e ka kuptuar se e thërrasin Albin Baba shkaku se e konsiderojnë të denjë dhe të domosdoshëm që t'ua rrisë fëmijët, jo vetëm të sektit të LV-së, por edhe të tjerëve. Çfarë idiotë dhe çfarë idiotësie!!!!!!

Legia, Frenki Simatoviq dhe Dejana Mihali: Legia dhe Frenki Simatoviq ishin udhëheqës të njëjseve paramilitare që bënë shumë krime lufte dhe krime kundër njerëzimit në Kroaci, Bosnje dhe Kosovë, sidomos kundër popullatës civile. Ishin vrasës me pagesë, kriminelë që u vënë në shërbim të politikës. Paramilitarët e këtyre njësiteve kriminale identifikoheshin me kapela - bereta të kuqe. Ngjyra e kuqe paraqet rrezik dhe ngre alarm, nëse lajmërohet edhe te veturat e deri te sistemet më të komplikuar. Flitej dhe flitet për Beretat e Kuqe të Legias dhe Frenkit. Po çka i ndërlihdhë këta kriminelë me Dejana Mihalin? Dejana Mihali është kriminele ideologjike dhe politike. Nga institucionet më të larta të sigurisë së Kosovës ishte shpallur e padëshiruar dhe e rrezikshme për sigurinë e vendit. Nga kuislingia Osmani dhe mercenarja Shvarc ishte pajisur me shtetësi dhe dokumente të rregullta të Kosovës, me shpejtësi të dritës dhe kundër procedurave të parapara ne ligj. Nën bekimin e Albin Babës, me vulën e Komandant Kaçketës, dezertorit të luftës me status të pranuar të veteranit të luftës. Dejana Mihali është dhunuese

nën hije e skenës politike në Kosovë, Maqedoni të Veriut dhe cep më cep ku jetojnë shqiptarët. Sidomos në diasporë. Në Shqipëri, i Gjati e shtriu për toke, nuk u rritë as si filizë. Në Greqi thuhet se i shkon fjala. Nuk ka aferë korruptive apo kombëtarisht destruktive në Kosovë ku ajo nuk përmendet apo nuk është e pranishme. Analfabetët dhe analfabetet e LVV-së përjetojnë orgazëm për një kafë apo foto me këtë Laddy Makbeth që as vizitorët e Shtëpisë së Bardhë në Washington nuk e ndjejnë gjatë takimit, me pagesë me presidentin amerikan. Dejana Mihali e pati ftuar të shkretin Nagip në takim për të diskutuar për prodhimin dhe shitblerjen e rrymës në Bangladesh duke i vendosur vetëm një kusht, të vijë me kapelë. Dhe i shkreti Nagip erdhi me kapelë në kokë e që u shndërrua në saç, asi me të cilin piqen flitë. Kriminelja ideologjike, politike dhe antikombëtare, Dejana Mihali ftoi vajzat dhe gratë e LVV-së që në koka të vendosin kapela - bereta të kuqe, gjatë fushatës mashtruese për zgjedhjet e 9 shkurtit 2025. Dhe shumë prej tyre e dëgjuan. Ece dhe kundërshtojë, duhet të kesh dy palë b...ë! Beretat e Kuqe të Dejana Mihalit janë nënshtrim ndaj një autoriteti suprem të pakundërshtueshëm, ndaj një vartësie të kushtëzuar me një post partiak, politik apo institucional. A është i ndikuar Albin Baba nga Baba Dejana? Thonë se po, nuk kam fakte. Duket se njerëz të rrezikshëm bartin kapela - bereta të kuqe si Legia, Frenki në Serbi, Dejana në Kosovë dhe të Vetëvendosjes "shqiptari" sikur edhe Donald Trampi në Amerikë. Triada e rrezikut dhe së keqes.

Afër fundit të mashtrimeve dhe premtimeve: Fushata është duke përfunduar dhe mirë po bëhet. Albin Baba, si Cezar i LVV-së i vetmuar e bënë fushatën, i janë lodhur

mashtit e partisë. Kundërshtarët po e marrin si të marrë, ashtu duket në paraqitje por çdo veprim e ka të mirëplanifikuar, me ndikim dhe pasoja afatgjate. Ai e ka shumë të qartë adresën ku do ta dërgojë mallin dhe pranuesin e mallit, te analfabetët funksionalë. Te ata që e urrejnë luftën çlirimtare, UÇK-në dhe ushtarët e lirisë. Te ata që i kanë shërbyer Jugosllavisë dhe Serbisë. Te ata që punën e parë e kanë te Albini. Të mbrosh hajnat, antikombëtarët, të pafytyrët, të pamoralshmit për një grusht vota dhe pushtet nënkupton se je me ta dhe sikur ata. Albinit nuk do t'i dalin llogaritë siç i ka projektuar bashkë me Baba Dejonën sepse as Nastradin Hoxhës nuk i kanë dalë. As grofit Minhauzen ndonëse njihet dhe është sinonim i mashtruesit më të madh nuk i kanë dalë. As Don Kishotit nuk i dolën. Albin Kurti ka hyrë në furrën e djegies politike, sa më shumë ta shtyjë, djegiet do të jenë më të mëdha. Albin Kurtit po i vijnë faturat e Bacë Adem Demaçit dhe të gjithë atyre që i ka dribluar e që dikush e ka paguar me para, që është shumë më e lehtë se ata që e kanë paguar ne jetë. PDK, LDK dhe AAK - NISMA po bëjnë fushatë të qetë, me shumë të pranishëm dhe pa perde të zeza. Koalicioni për Familjen sikur po bënë fushatë në kushte ilegaliteti, pak po duket. Nëse zgjedhjet do të mbahen më 2 shkurt 2025, rezultatet do të ishin: LVV-ja 29 - 32 për qind, PDK-ja 23 - 26 për qind, LDK-ja 20 - 23 për qind, AAK - NISMA 9 - 12 për qind dhe Familja 4 - 6 për qind. Lejohet margjina plus minus tre për qind. Këto rezultate i kam paraparë përafërsisht para 6 muajve. Asnjë parti nuk i kalon 330.000 "zemra". Dyshoj as aq. Pushim të këndshëm në fundjavë mund të keni vetëm nëse nuk besoni çdo gjë çka shihni dhe çka dëgjoni gjatë fushatës.

IKShPK-ja nis fushatën e ndërgjegjësimit për parandalimin e kancerit

PRISHTINË, 4 SHKURT - Me rastin e Ditës Botërore të Kancerit, Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka filluar të martën një sërë aktiviteteve vetëdijesuese për parandalimin e kancerit të qafës së mitrës. Në kuadër të këtyre aktiviteteve janë shpërndarë broshura me mesazhin "Kanceri i qafës së mitrës mund të parandalohet. Bëje PAP testin!". Broshurat janë shpërndarë në institucione me numër të madh punëtorësh, si: Posta

dhe Telekomit i Kosovës, KEDS-u dhe organizata dhe institucione të tjera publike dhe private. Qëllimi i fushatës është rritja e ndërgjegjësimit të grave dhe vajzave mbi rëndësinë e kontrolleve të rregullta dhe masave parandaluese për kancerin e qafës së mitrës. Aktivitetet do të vazhdojnë gjatë gjithë muajit, përfshirë shpërndarjen e materialeve informuese, ligjërata dhe sesione ndërgjegjësuese, vizita në shkolla dhe komunitete.



Shembet muri i një ndërtese në Qendrën Historike, institucionet nuk ndërmerren masa emergjente mbrojtëse

PRIZREN, 2 SHKURT - Muri i ndërtesës me fasadë karakteristike në rrugën "Marin Barleti" në Prizren është shembur disa muaj pasi që komisioni komunal për vlerësimin e objekteve që paraqesin rrezikshmëri për qytetarët ka adresuar komentin se duhet të merren masa dhe të intervenohet sa më parë nga institucionet përkatëse që të parandalohet ndonjë fatkeqësi. Kështu ka thënë OJQ "EC Ma Ndryshe". Ky komision më 26 shtator 2024 ka qenë në terren, në objektin në ngastrën kadastrale nr. 03338-1, e pas evidentimit në vendin e ngjarjes, ka pohuar se, pas zhvillimeve të punimeve në ngastrën fqinje për gërmimin e bodrumit, ka ardhur deri te dëmtimi i themelit të ndërtesës, e cila ka pësuar zhvendosje dhe, për pasojë, janë paraqitur plasaritje dhe humbje në stabilitet. Komisioni asokohe ka pohuar se objekti rrezikon të shembet dhe paraqet rrezik permanent për pronarët dhe kalimtarët, të cilët frekuentojnë në perimetër të objektit, dhe ka kërkuar masa e intervenim të menjëhershëm. Pas këtij raport, më 10 tetor 2024 edhe QRTK-Prizren ka

kërkuar nga DES marrjen e masave lidhur me këtë ndërtesë. "Sipas verifikimit në terren, gjatë punimeve në ngastrën e lartpërmendur, përmes gërmimit me ekskavator është dëmtuar ndërtesa fqinje dhe se, pas shkakut të dëmit të konstatuar nga inspektorati, nuk është ndërmarrë asnjë masë mbrojtëse për sigurimin statik dhe parandalimin e shkatërrimit total të ndërtesës dhe rrezikimit e kalimtarëve të rastit. Andaj, sipas kompetencave dhe përgjegjësi tuaja, kërkojmë të ndërmerren masat emergjente mbrojtëse për ndërtesën në ngastrën kadastrale P-71813068-03338-1", thuhet në shkresën e QRTK-Prizren.

Pas shembjes së një pjese të ndërtesës gjatë javës së shkuar, QRTK-Prizren më 30 janar 2025 sërish ka dërguar një shkresë në adresë të DES-it, ku thuhet se nuk është ndërmarrë asnjë masë, dhe se pas ndodhisë inspektorët komunalë e kanë siguruar hapësirën përmes vendosjes së shiritave për pengimin e qarkullimit të njerëzve në këtë hapësirë. Sipas QRTK-së, hapësira ku ndodhet kjo ndërtesë është brenda



Qendrës Historike të Prizrenit, e cila gëzon status të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Në vijim QRTK ka ofruar udhëzime për ndërmarrjen e masave parandaluese të rrezikut në mënyrë që të aplikohen standardet për ruajtjen e mbrojtjen efektive të trashëgimisë kulturore. Komisioni komunal për vlerësimin e objekteve që paraqesin rrezikshmëri për qytetarët më 30 janar 2025 ka dalë në terren për të inspektuar këtë ndërtesë dhe

ka konstatuar se situata është përkeqësuar më tej, "pasi një mur i ndërtesës është shembur plotësisht, duke rritur ndjeshëm rrezikun për banorët dhe kalimtarët". Komisioni edhe në këtë rast ka vlerësuar se ndërhyrja emergjente është e domosdoshme për të parandaluar dëme të mëdha materiale dhe njerëzore. Lidhur me këtë rast, EC ka kërkuar informata edhe nga DI, por ende nuk ka pranuar ndonjë përgjigje.

Për EC-in, neglizhenca e institucioneve përkatëse për të ndërmarrë masa emergjente mbrojtëse në raste të tilla është e papranueshme për shkak se në këtë mënyrë mund të rrezikohen jetët e njerëzve. EC përsërit qëndrimin e kahershëm se siguria e qytetarëve është prioritet, dhe në këtë linjë thekson qëndrimin se institucionet përgjegjëse në bashkëpunim me komunitetin duhet të ndërmerren veprime adekuate me kohë që ndërtesat e vjetra mos të degradojnë deri në masën sa të paraqesin rrezik për sigurinë e pronarëve të tyre dhe qytetarëve të tjerë. Në këtë rast edhe zhvillimi i punimeve nga investitorët e punëkryesit duhet të jetë i kujdesshëm për mosdëmtimin e strukturave të ndërtesave të vjetra në Qendrën Historike. Për këtë arsye, EC kërkon nga institucionet përgjegjëse ta rrisin vigjilencën për ta monitoruar situatën e punimet, dhe për të ndërmarrë veprime të duhura ligjore me kohë ashtu që ndërtesat e vjetra në Qendrën Historike mos të shndërrohen në rrezik për qytetarët, por të jenë vlerë e qytetit dhe t'i shërbejnë zhvillimit të qëndrueshëm.

ATK-ja konfirmon çmimet e tregut për barna, OFK-u kërkon nga MSh të marrë veprime për ta parandaluar dëmtimin e barnatoreve

PRISHTINË, 4 SHKURT - Oda e Farmacistëve e Kosovës (OFK) ka kërkuar opinion ligjor nga Administrata Tatimore e Kosovës lidhur me vendimin e Ministrisë së Shëndetësisë për çmimet e barnave. OFK ka mirëpritur opinionin ligjor të ATK-së që, sipas saj, konfirmohet se çmimi i produkteve farmaceutike duhet të jetë vlera e hapur e tregut, por jo më pak se çmimi i kostos së prodhimit dhe shpërndarjes. Në një njoftim OFK theksoi se ky opinion i ATK-së është një hap i rëndësishëm drejt sigurimit të transparencës



dhe mbrojtjes së interesave të barnatoreve dhe industrisë farmaceutike në Kosovë. Po ashtu, Oda kërkoi nga Ministria e Shëndetësisë dhe organet përkatëse të

ndërmarrin veprime të menjëhershme për ta parandaluar dëmtimin e barnatoreve për shkak të stokut të tepruar dhe vendimeve të kundërligjshme

që ndodhin në këtë proces. "Oda e Farmacistëve të Kosovës, mirëpret opinion ligjor të ATK-së me të cilin konfirmohet se çmimi i produktit duhet të jetë vlera e hapur e tregut, por jo më pak se çmimi i kostos. OFK fton edhe njëherë Ministrinë e Shëndetësisë dhe organet vartëse të saj nga ndërmarrja e veprimeve për stokun me të cilat dëmtohen barnatoret në implementimin e vendimeve të kundërligjshme", thuhet në njoftimin e OFK-së. OFK shprehu gatishmërinë për të bashkëpunuar me

Ministrinë e Shëndetësisë dhe institucionet e tjera të rëndësishme për të siguruar implementimin e ligjshmërisë së këtij vendimi në terren. Edhe Shoqata e Distributorëve të Produkteve Farmaceutike dhe Medicinale të Kosovës (ShDPFMK) ka reaguar lidhur me vendimin e fundit të Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) për përcaktimin e çmimeve të barnave, duke shprehur shqetësimin për ndikimin që ky vendim mund të ketë në tregun farmaceutik dhe furnizimin me barna në Kosovë.

Kosova dhe Mali i Zi krijojnë reciprocitet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore

PRISHTINË, 4 SHKURT - Kosova dhe Mali i Zi kanë krijuar reciprocitet për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe komerciale, ka bërë me dije ministrja e Drejtësisë, Albulena Haxhiu. Haxhiu ka theksuar te tash e tutje vendimet e lëshuara nga

gjykatat e Kosovës mund të njihen dhe ekzekutohen në Mal të Zi dhe anasjelltas. "Krijohet reciprocitet në mes Republikës së Kosovës dhe Malit të Zi për njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në çështjet civile dhe komerciale. Nga tani e tutje vendimet e lëshuara nga

Gjykatat e Republikës së Kosovës në çështjet civile dhe komerciale mund të njihen dhe ekzekutohen në Malit të Zi dhe anasjelltas", ka shkruar Haxhiu. Ministrja ka theksuar se ky është një zhvillim i rëndësishëm në mes dy vendeve. "Ky është një zhvillim i rëndësishëm që do

të mundësojë një rrjedhë më të lehtë të njohjes dhe ekzekutimit të vendimeve të gjykatave të Kosovës, duke përmirësuar bashkëpunimin juridik dhe duke ndihmuar në forcimin e marrëdhënieve ndërkombëtare në këtë fushë ndërmjet dy shteteve në fjalë", ka shkruar Haxhiu.



Dogana e Kosovës vë në menaxhim terminalin doganor në Han të Elezit dhe në Dheun e Bardhë

PRISHTINË, 4 SHKURT - Dogana e Kosovës ka bërë me dije se me vendim të qeverisë për shpronësim dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave të shpronësimit të terminaleve doganore në

Han të Elezit dhe në Dheun e Bardhë, ka vendosur nën menaxhim të plotë edhe këto dy terminale.

Dogana në "Facebook" njofton se tani e tutje nuk do të ketë pagesë për tarifa të hyrjes në

terminale gjë që ndikon në uljen e kostos së operimit të bizneseve e si rrjedhojë kjo do të reflektojë edhe në uljen e çmimeve të produkteve në treg. "Evitimi i pagesës së tarifës për hyrje në terminal

është, gjithashtu, adresim i sfidave të raportuara në raportin e vendit nga Komisioni Evropian, andaj kjo përbën edhe një hap të rëndësishëm në proceset integruese", thuhet në njoftim.



Haradinaj takon bizneset: Rritje ekonomike 7 %, infrastrukturë moderne dhe përkrahje për biznese

PRISHTINË, 2 SHKURT - Kandidati për kryeministër Ramush Haradinaj ka paraqitur të martën planin ekonomik të koalicionit "Kosova Fituese", duke premtuar investime kapitale prej 25 miliardë eurosh, prej të cilave 16 miliardë pritet të vijnë nga sektori privat.

Gjatë takimit me përfaqësues të bizneseve, Haradinaj paraqiti një vizion ambicioz për transformimin ekonomik të vendit, duke synuar rritje ekonomike deri në 7 %. "Qeverisja jonë do të jetë partnere me biznese. Ne do ta hapim rrugën për një zhvillim të hovshëm ekonomik përmes

politikave buxhetore efektive, masave fiskale që përkrahin biznese dhe politikave tregtare që nxisin prodhimin dhe eksportin", ka thënë kandidati për kryeministër.

Plani parashih investime madhore në infrastrukturë, duke përfshirë 3 miliardë euro për rrugë, 1.5 miliard për arsim dhe shëndetësi, si dhe 1 miliard euro për modernizimin e hekurudhave. Një theks i veçantë i është kushtuar furnizimit të pandërprerë me energji elektrike dhe ujë, si dhe krijimit të zonave të reja ekonomike biznesore në të gjithë vendin. "Ne do të

ofrojmë lehtësira të konsiderueshme për biznese, përfshirë lirin nga tatimi në fitim për 5 vjet për investitorët e rinj dhe mbulimin e 50 % të pagës për 6 muaj për biznese që punësojnë gra", është shprehur Haradinaj, duke theksuar se këto masa do t'i stimulojnë investimet dhe punësimin.

Programi parashih projekte të rëndësishme me partneritet publiko-privat, përfshirë ndërtimin e termocentralit me gaz në Ferizaj, zhvillimin e projekteve të energjisë së ripërtërishe dhe modernizimin e Trepçës. Të hyrat totale buxhetore gjatë



mandatit qeveritar pritet të arrijnë në 22.5 miliardë euro, duke përfshirë edhe rritjen e borxhit publik.

E dërguan në Kushtetuese, Murati: PDK-ja dhe LDK-ja nuk e kuptojnë rëndësinë e Fondit Sovran

PRISHTINË, 4 SHKURT - Ministri i Financave, Hekuran Murati, ka drejtuar kritika ndaj Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) lidhur me Ligjin për Themelimin e Fondit Sovran. Dërgimin në Kushtetuese të këtij ligji nga PDK-ja e LDK-ja, Murati e ka cilësuar pengesë për zhvillimin ekonomik të vendit. Ai ka theksuar se ky ligj, i miratuar nga Qeveria e Kosovës, do të ishte një katalizator i rëndësishëm për



rritjen dhe zhvillimin ekonomik të Kosovës. Murati ka ngritur një paralele

duke thënë se derisa ky ligj ndodhet në Kushtetuese, presidenti i Shteteve të

Bashkuara të Amerikës, Donald Trump, ka miratuar një vendim të ngjashëm për themelimin e një Fondi Sovran për ShBA-në. "Në anën tjetër, Ligjin për Themelimin e Fondit Sovran që e kemi miratuar e që do të ishte katalizator i zhvillimit ekonomik, LDK-ja e PDK-ja e kanë çuar në Gjykatë Kushtetuese. Kurse dje presidenti Trump e miratoi vendimin për themelimin të Fondit Sovran të ShBA-së", ka shkruar Murati në "Facebook".

Ai shtoi se disa ekonomistë të këtyre partive nuk i kuptojnë plotësisht konceptet ekonomike dhe se vetëm pas disa vitesh ata mund ta kuptojnë rëndësinë e një mekanizmi të tillë financiar. "Kanihere kam përshtypjen që këta ekonomistët e LDK-së dhe PDK-së, jo që nuk duan, por nuk i kuptojnë disa koncepte ekonomike. Tek pas disa vjetësh po i marrin vesh, kur po ndodhin edhe në shtete tjera", ka shkruar Murati.

Urdhri i Trumpit për ndalimin e përkohshëm të ndihmës së huaj, GAP: Në Kosovë ndikohen rreth 17 projekte aktive

PRISHTINË, 4 SHKURT - Urdhri i presidentit të ShBA-së, Donald Trump, për ndalimin e përkohshëm të ndihmës së huaj për 90 ditë, në Kosovë ndikon në rreth 17 projekte aktive të financuara nga USAID-i që japin kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e vendit. "Disa prej tyre kanë filluar që para pandemisë dhe shumica prej

tyre zbatohen nga kompani amerikane e disa më të vogla nga organizata vendore. Përfituesit kryesorë përfshijnë institucione publike si komunat, ministritë, agjencitë e pavarura, universitetet, gjykatat, po ashtu mediet, sektorin privat dhe organizatat e shoqërisë civile", ka njoftuar instituti GAP. Ditë më parë Administrata e



presidentit Donald Trump ka pezulluar për tre muaj pothuajse të gjitha ndihmat e huaja, ndërsa autoritetet amerikane po verifikojnë se cilat nga këto ndihma i përshtaten politikës së presidentit "Amerika e para". Shtetet e Bashkuara kanë ndarë pothuajse 70 miliardë dollarë ndihma të huaja gjatë vitit fiskal

2023, shumica përmes Agjencisë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar, USAID. Trumpi bllokoi shumicën e këtyre ndihmave në përpjekje për të verifikuar nëse ato i përshtaten politikës së tij, "Amerika e Para". Urdhri presidencial ndalon përkohësisht ndihmat për 90 ditë derisa kryhet rishikimi.

Industria e Naftës e Serbisë kërkon nga ShBA-ja shtyrjen e sanksioneve

BEOGRAD, 4 SHKURT - Industria e Naftës e Serbisë (NIS) ka dorëzuar një kërkesë zyrtare në Departamentin për Kontrollin e Pasurive të Huaja të Departamentit të Thesarit të Shteteve të Bashkuara të

Amerikës (OFAC) për shtyrjen e sanksioneve, njoftoi të martën, më 4 shkurt, ministria e Minierave dhe Energjisë e Serbisë, Dubravka Gjedoviq Handanoviq. Ajo shtoi se është kërkuar nga ShBA-ja t'i shtyrë

sanksionet për të paktën 90 ditë dhe se këtë kërkesë e kanë mbështetur Qeveria e Serbisë dhe ajo e Hungarisë. Shtetet e Bashkuara e kanë vendosur NIS-in në listën e sanksioneve më 10 janar për

shkak të pjesëmarrjes në pronësi të kompanisë ruse, "Gazprom Neft", me qëllim të parandalimit të Rusisë që t'i përdorë të ardhurat nga sektori energjetik për luftën në Ukrainë.

Kompanitë ruse, "Gazprom Neft" dhe "Gazprom", zotërojnë shumicën e aksioneve në NIS (56.15 për qind), ndërsa Serbia ka në pronësi gati një të tretën e aksioneve.

Donald Trump, premtimet e mbajtura dhe pasojat globale

Presidenti i SHBA po bën ekzaktësisht atë që tha se do të bënte



Donald Trump po bën saktësisht atë që ka premtuar. Me një ritëm të shpejtë, ai po zbaton politikën që ka premtuar në fushatën e tij, duke nisur një luftë tregtare të ashpër, duke forcuar kufizimet për emigracionin dhe duke çmontuar pjesë të rëndësishme të administratës federale. Këto lëvizje kanë sjellë trazira dhe risqe jo vetëm për SHBA-në, por edhe për botën mbarë.

Lufta tregtare dhe pasojat ekonomike

Një nga politikën më të debatuar të administratës Trump ka qenë vendosja e tarifave të larta mbi importet nga Kanadaja, Meksika dhe Kina. Presidenti ka shpallur tarifa prej 25% për mallrat nga Kanadaja dhe Meksika (për momentin të pezulluara), si dhe 10% mbi importet kineze. Ai ka argumentuar se këto masa do të mbrojnë industrinë amerikane dhe do të rrisin prodhimin vendas.

Por, këto tarifa kanë shkakuar reagime të ashpra nga partnerët tregtarë të SHBA-së. Kanadaja ka njoftuar masa "hakmarrëse" mbi më shumë se 100 miliardë dollarë importe nga SHBA, ndërsa Meksika ka premtuar një reagim të ngjashëm. Këto veprime pritet të ndikojnë në çmimet e

konsumit në SHBA, duke i bërë produktet më të shtrenjta për qytetarët amerikanë. Ish-sekretari i Thesarit, Larry Summers, ka paralajmëruar se këto tarifa mund të shkaktojnë një rritje të inflacionit dhe një dëm të konsiderueshëm për ekonominë amerikane. Ekspertët ekonomikë gjithashtu po paralajmërojnë se kjo luftë tregtare mund të çojë në humbjen e mijëra vendeve të punës dhe në një recesion të mundshëm global.

Zhvlërësimi i marrëveshjeve ndërkombëtare

Trump ka tronditur marrëdhëniet ndërkombëtare duke shpallur daljen nga marrëveshjet dhe traktatet e rëndësishme. Një nga veprimet më drastike ka qenë tërheqja nga Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Amerikës së Veriut (NAFTA), të cilën ai e kishte quajtur "marrëveshjen më të keqe të bërë ndonjëherë".

Ndërkohë, ka kërcënuar se do të rimarrë kontrollin e Kanalit të Panamës, një veprim që mund të shkaktojë tensione të mëdha gjeopolitike. Sekretari i Shtetit, Marco Rubio, ka paralajmëruar Panamanë se SHBA do të marrë "masat e nevojshme" për të mbrojtur interesat e saj, duke përmendur

faktin se kompani me qendër në Hong Kong kanë investuar në dy porte kryesore pranë kanalit.

Këto veprime po shqetësojnë aleatët e SHBA-së, të cilët po shohin një prishje të rendit ndërkombëtar të krijuar për disa dekada. Analistët paralajmërojnë se një izolim i mundshëm i Amerikës mund të çojë në dobësimin e pozitës së saj globale dhe në forcimin e fuqive si Kina dhe Rusia.

Masat ndaj emigracionit

Një tjetër fushë ku Trump po vepron me vendosmëri është emigracioni. Ai ka urdhëruar dëbimin masiv të emigrantëve të paligjshëm, duke prekur veçanërisht mbi 300,000 venezuelianë që kishin fituar status në SHBA. Ky vendim është pritur me shqetësim nga organizatat e të drejtave të njeriut, të cilat paralajmërojnë se dëbimi i këtyre personave në një vend të tronditur nga kriza humanitare do të ketë pasojë katastrofike.

Në të njëjtën kohë, administrata e tij ka forcuar sigurinë në kufirin jugor, duke penguar hyrjen e emigrantëve dhe duke ndërtuar barriera të reja. Këto politika kanë nderur debate të mëdha brenda vendit, me kritikët që i cilësojnë si "të pamëshirshme" dhe "të padrejta".

Goditje ndaj administratës federale dhe medias

Trump ka nisur gjithashtu një pastrim të gjerë në administratën federale. Më shumë se një duzinë prokurorësh që kishin ndjekur çështjet e 6 janarit 2021 janë shkarkuar, ndërsa janë kërkuar emrat e agjentëve të FBI-së që kanë hetuar çështjet kundër tij. Ndërkohë, Elon Musk, i cili ka marrë një rol të pazakontë në këtë administratë, ka fituar qasje në sistemet e pagesave të qeverisë, një veprim që ka ngritur shqetësimet për konfliktin e interesit dhe për abuzim të mundshëm me fondet publike. Ai gjithashtu ka sulmuar publikisht Agjencinë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), duke e quajtur një "organizatë kriminale" dhe duke kërkuar mbylljen e saj.

Reagimi i aleatëve

Kanadaja dhe Meksika kanë reaguar ashpër ndaj politikave të Trump. Kryeministri kanadez, Justin Trudeau, e ka quajtur këtë një "sulm të drejtpërdrejtë ndaj sovranitetit kanadez" dhe ka theksuar se vendi i tij nuk do të lejojë asnjë kërcënim ndaj pavarësisë së tij ekonomike dhe politike.

Në një deklaratë të ashpër, ish-

ministria e Financave e Kanadasë, Chrystia Freeland, ka thënë: "Amerikanët do të habiten nga reagimi ynë. Ne jemi të lënduar, por mbi të gjitha, jemi të zemëruar dhe të bashkuar." Meksika, nga ana tjetër, ka deklaruar se sovraniteti i saj nuk është i negociueshëm dhe ka kërkuar që çështjet të zgjidhen përmes diplomacisë dhe jo konfrontimit.

Çfarë do të ndodhë?

Me gjithë polemikat, mbështetësit e Trumpit vazhdojnë ta shohin atë si një lider të vendosur, i cili nuk ka frikë të përballet me burokracinë dhe elitën ndërkombëtare. Senatorët republikanë, si JD Vance dhe Marco Rubio, kanë mbështetur lëvizjet e tij, duke thënë se ai po bën atë që çdo president duhet të bëjë: të zbatojë vullnetin e popullit që e zgjodhi.

Megjithatë, pasojat e këtyre politikave janë ende të paqarta. Ndërsa Trump vazhdon të mbajë premtimet me një ritëm të shpejtë, pyetja kryesore mbetet: a do ta bëjë kjo Amerikën më të fortë, apo më të izoluar? Nëse historia ka treguar diçka, është se vendimet e mëdha kanë gjithmonë pasojë të paparashikueshme. Dhe për momentin, e gjithë bota po përgatitet për atë që do të vijë. / bota.al

EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
 Enverti
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com



Gjimshiti në formacionin e javës në Serie A

BERGAMO, 4 SHKURT - Mbrojtësi Berat Gjimshiti është futbollisti i vetëm shqiptar që ka zënë vend në formacionin më të mirë të javës së 23-të në Serie A të Italisë. Futbollisti i

Shqipërisë është vlerësuar lart për paraqitjen e tij në barazimin 1:1 të Atalantas kundër Torinos, ndeshje kjo e luajtur javën e shkuar. Gjimshiti ka shënuar gol në këtë ndeshje dhe ka fituar 8

prej 9 dueleve me kundërshtarët, duke u vlerësuar me notën 8.2, e cila i ka siguruar një vend në formacionin më të mirë të javës. 31-vjeçari është kapiten i Atalantas dhe njëri

ndër mbrojtësit më të vlerësuar në Serie A. Në 32 ndeshje të luajtura në të gjitha garat deri më tani, ai ka shënuar edhe dy gola për Atalantan, ekip me të cilin ka kontratë deri në vitin 2026.



Vojvoda pas transferimit te Como: Jam i lumtur dhe krenar

COMO, 4 SHKURT - Mbrojtësi i Kosovës, Mërgim Vojvoda, në fund të afatit kalimtar të janarit ka vendosur të ndryshojë skuadër. Ai mbetet në Seria, por nga Torino tash ka kaluar tek Como. Vojvoda ka nënshkruar me këtë klub deri në vitin 2028-të. 30-vjeçari pasi i dha fund eksperiencës së suksesshme me Torinon, foli për herë të parë si futbollist i ri i Comos, ku iu bashkua trajnerit Cesc Fabregas, i cili e kërkoi atë me ngulm. Mbrojtësi i djathtë, por njëkohësisht edhe i djathtë ndihet i lumtur për këtë transferim, ndërsa premtori se do ta japë më të mirën nga vetja. "Jam i

lumtur dhe krenar që jam këtu dhe i gatshëm për të ndihmuar ekipin. Serie A nuk është një ligë e lehtë, por mendoj se skuadra ka cilësi. Kam biseduar me trajnerin dhe jam këtu për të punuar për projektin", ka thënë Vojvoda pasi nënshkroi me Comon. Vojvoda i ka zhvilluar mbi 100 ndeshje në Serie A me Torinon dhe përvoja është në anën e tij. Me Comon, futbollisti me prejardhje nga Drenica synon ta ruajë statusin e ekipit elitari në futbollin italian. Ai u lind në Liege të Belgjikës. Mërgim Vojvoda ka luajtur në disa klube të atjeshme, përfshirë këtu Standard Liège dhe Royal

Excel Mouscron. Ai po ashtu është pjesë e rregullt dhe e rëndësishme e Kombëtares së Kosovës, me të cilën i ka mbi 60 paraqitje që prej debutimit të tij në vitin 2016.

Fabregas: Vojvoda ka eksperiencën e duhur, do ndihmojë Comon

Trajneri i Comos, Fabregas, në një intervistë të dhënë së fundmi, vlerësoi në maksimum mbrojtësin shqiptar, Mërgim Vojvoda. "Mërgimi sjell përvojë, këmbëngulje dhe qëndrueshmëri në mbrojtje në skuadrën tonë. Aftësia e tij për të operuar në role të



shumta mbrojtëse dhe përvoja e tij në Serie A do të jenë të paçmueshme ndërsa ne vazhdojmë ta forcojmë

vijën tonë defensive", ka deklaruar Fabregas. Vojvoda ka nënshkruar kontratë deri në vitin 2028.

Shqipëria dhe Serbia e fitojnë të drejtën e organizimit të Evropianit U-21



TIRANË, 4 SHKURT - Shqipëria dhe Serbia do ta organizojnë Kampionatin Evropian të Futbollit për moshat U-21. Kjo u vendos në mbledhjen e Komitetit Ekzekutiv të UEFA-s. Pra, gjithçka u konfirmua të martën nga shtëpia e futbollit evropian, me dy vendet që do ta organizojnë këtë eveniment në vitin 2027.

Në Shqipëri ndeshjet do të luhen në Tiranë, Shkodër, Durrës e Elbasan. Evropiani U-21 do të hapet në stadiumin "Karadjordje" të Novi Sadit, ndërsa do të luhet edhe në Leskovc, Zaječar dhe Loznicë. E finalja do të luhet në stadiumin "Air Albania" në Tiranë. Shqipëria do t'i luajë ndeshjet në Shqipëri e Serbia

në Serbi. Vetëm nëse shkojnë eventualisht në finale, serbët do të luanin në Shqipëri. Shqipëria, si organizatore, do ta fitojë të drejtën e kualifikimit direkt në këtë eveniment, i cili është kritikuar me të madhe nga shqiptarët anëmbanë botës shkak i së kaluarës mes dy popujve.

Vlora Braha, delegatja e parë teknike nga Kosova në kualifikimet për FIBA Kampionatin Evropian për Femra

PRISHTINË, 4 SHKURT - Federata e Basketbollit e Kosovës ka kënaqësinë të njoftojë se, Vlora Braha do të jetë për herë të parë në rolin e Delegates Teknike në një ndeshje kualifikuese për FIBA Kampionatin Evropian 2025 për Femra. Ajo do të jetë Delegate Teknike në ndeshjen mes Turqisë dhe Islandës, që zhvillohet më 6 shkurt në Izmit, nga ora 17:00. Braha ka qenë më parë

shoqëruese e Delegates Teknik në disa ndeshje kualifikuese të këtij kompeticioni. Pas një pune të suksesshme dhe vlerësimeve pozitive nga FIBA, ajo tani është emëruar në rolin e Delegates Teknike, duke shënuar një moment historik për basketbollin kosovar dhe duke u bërë kështu Delegates e Parë Teknike e Federatës së Basketbollit të Kosovës në të dyja konkurrencat. Kjo arritje

dëshmon përkushtimin e FBK-së për të promovuar ish-basketbollistët dhe ish-basketbollistët që dëshirojnë të mbeten aktivë/e në sport edhe pas përfundimit të karrierës si lojtarë/e. Ky është një hap i rëndësishëm për basketbollin kosovar në arenën ndërkombëtare dhe një shembull i qartë i angazhimit të FBK-së për zhvillimin e profesionistëve të rinj në sport.







ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA

1992

